

# Gazeta e Prindit #5

## "Foleja e Shqiponjave"

Shkurt, 2019

2445 23 Ave SW, Calgary, AB T2T 0W3

Website: <https://www.albcanyyc.org/>

T: 403-466-4172

email : 12dracana@gmail.com



Ju lutemi n'a kontaktoni me pyetjet dhe kërkesat dhe këshillat tuaja. Kjo gazetë e përmuajshme do të shpërndahet me postë elektronike. Ne do të përdorim adresën tuaj të e-mailit për të komunikuar me ju. N'a njoftoni nëse ky është problem për ju.

## Ngjarjet e ardhëshme

**KUR: E Shtune, 30 Mars, 2019 3:30pm - 5:00pm**

**CFARË:** Seminar Informues – Si aplikohet per universitet dhe gjetja e bursave te studimit.


**KU:** Shkolla North Point/ Foleja e Shqiponjave

**Adresa: 2445 23 Ave SW, Calgary, AB T2T 0W3**

### NJOFTIM I RËNDËSISHËM

Te dashur bashkeatdhetare ne Calgary. Seminari me informacione se si te ndihmoni femijet tuaj qe jane ne shkollen e mesme per t'u pranuar ne universitet dhe per te fituar bursa te ndryshme do te ofrohet perseri ditën e Shtune me daten 30 Mars ne ora 3:30 pm-5:00 pm tek North Point School for Boys / Shkolla "Foleja e Shqiponjave". Shpresojme se kjo ju jep kohe te mjaftueshme per te rezervuar pak kohe ne ditet tuaja te ngarkuara per kete seminar informues qe organizohet nga bordi i shkolles Foleja e Shqiponjave. Ju luten bejeni "share" kete informacion. N'a kontaktoni me pyetjet tuaja ne 12dracana@gmail.com

**IMAGJINONI VEHTEN APO FEMIJET TANE NE KETE BIBLIOTEKE TE BUKUR DUKE STUDJUAR DHE PA PAGUAR (SEPSE KA AQ SHUME BURSA TE MUNDESHME).**



## **NDRYSHIME NE PROGRAMIN E SHKOLLËS SHQIPE “Foleja e Shqiponjave” CALGARY, ALBERTA**

Programi vjetor i punës së shkollës shqipe “Foleja e Shqiponjave” për vitin shkollor 2018/19 në Calgary, Alberta, është hartuar në një kohë kur bashkëatdhetarët tanë kudo në diasporë janë përfshirë në vllugun e përpjekjeve për ruajtjen e gjuhës shqipe dhe traditave të popullit tonë në brezin e ri të fëmijëve që po rriten larg Atdheut.

Për semestrin e dyte (Shkurt- Qershor, 2019) janë bërë të gjitha përgatitjet e mundëshme për te organizuar shkollën në mënyrë të tillë që fëmijet të vijne me dëshirë dhe të përparojnë në mesimin e Gjuhës Shqipe. Për këtë qëllim mesimi ka filluar me tekste të reja shkollore dhe me një mesimdhënie me baze dixhitalizimin e dhenjes së dijeve gjuhësore dhe kulturore. Githashtu, duke patur parasysh që mesimi zhvillohet vetëm 2 orë në javë, nxenesve do t’u kërkohej që të punojnë me fletoret e punës për të ushtruar gjuhën shqipe në shtëpi. Shpresojmë se prinderit do të n’a perkrahin në këtë nismë.

Lokali shkollor është shumë i përshtatshëm për fëmijët tanë dhe mjetet e punës pedagogjike sic janë ditarët për çdo orë mesimi, arsimtarë të përgatitur, dhe një kurrikulum me baza shkencore janë siguruar tashmë. Arsimtarët e punësuar i përgjigjen kërkesave dhe përgjegjësisë për trajnime në fushën e mësimdhënjes në përgjithësi, asaj dixhitale dhe të mbështetur në aftësitë e trurit për të mësuar në vecanti.

Këtë semester kemi një risi në veprimtarinë e shkollës, një kombinim të mrekullueshëm të përvojës në mësimdhënie dhe kërkime shkencore në fushën e pedagogjisë dhe një mbështetje të mrekullueshme nga dyqani i pajisjeve elektronike, Best Buy. Ne kemi krijuar një ekip të përbashkët të shkolles dhe Best Buy, i cili ka hartuar një plan ku specialiste të Best Buy dhe Geeks Squad do të sjellin lodra të ndryshme elektronike një herë në muaj dhe do japin mesim me mesueset e shkolles duke përdorur këto lojra elektronike. Gjithashtu, për t’i ardhur me shume në ndihmë komunitetit Shqiptar në Kalgari, Bordi i Shkolles do të ofrojë seminare informative të permuajshme (të Dielën e fundit të çdo muaji) ku do të diskutohen çështje të rëndësishme për edukimin dhe shkollimin në Kanada. Shihni programin dhe datat për këto seminare në faqen e mëposhteme.

### **JU PRESIM TEK FOLEJA!**

## **Le t’u mësojmë fëmijëve Gjuhën Shqipe dhe kulturën tone!**

Askush tjetër s’ka mundur ta shprehë më mirë se sa i madhi Gjergj Fishta me fjalë dhe vargje shqetësimin për gjuhën tonë. Si emigrantë të ardhur nga gjiri i një prej popujve më të lashtë të Ballkanit, edhe i një kombi, beteja përjetësore e të cilit ka qënë kurdoherë për mbijetesë dhe identitet kombëtar; si prindër, e si individ të një shoqërie të civilizuar, ne shpesh pyesim veten përse, edhe shumica prej nesh nuk kanë jetuar më shumë se një dekadë jashtë atdheut, fëmijët tanë thërrasin nënën ‘mom’ dhe babën ‘dad’? Cila është arsyeja që edhe pse jetojmë në vendin më demokratik në botë, ku aftësia të zotërosh më shumë se sa një gjuhë, diversiteti, si dhe gjithëpërfshirja inkurajohen dhe mirëpritin, fëmijët tanë, të lindur në pjesën më dërrmuese nga të dy prindërit shqiptarë, nuk mund të flasin dhe lexojnë gjuhën e mëmës? E shprehur më qartë – **cila është arsyeja që ne si**

prindër nuk u mësojmë e kërkojmë fëmijëve tanë të flasim shqip? Përgjigjja e kësaj pyetje na vjen si keshillë apo mallkim nga poeti yne I madh:

*“Mallkuar qoft ai bir Shqiptari,  
Që këtë gjuhë të Perëndis,  
Trashigim, që na la i Pari,  
Trashigim s'ia lën ai fmis,  
Edhe atij iu thafte, goja,  
Që e përbuz këtë gjuhë Hyjnore  
Që n'gjuhë t'huaj, kur s'asht nevoja,  
flet e t'vetën lën mbas dore !!!  
(Sjergj Fishta, Tetor 1899)*

Pyetja sa e lehtë dhe e drejtpërdrejtë, kërkon dhe meriton një përgjigje gjithashtu të drejtpërdrejtë dhe aspak të ngjyrosur me justifikime dhe shtrëmbërime të së vërtetës. Edhe pse shpesh arsyet e dhëna nga shumë prindër nuk janë fare pa bazë, asnjë gjë nuk mund të justifikojë për asnjë moment, përse ne si prindër vazhdojmë me vetëdije të injorojmë listën e gjatë të përfitimeve dhe peshën tepër të rëndësishme që njohja e një gjuhe të dytë mbart! Fëmijet tane te mrekullueshem te Folese, po cicerrojnë si shqiponjat e vogla ne gjuhen e nezes:





## Informacion për prindërit e fëmijeve në shkollat e Albertës.

E drejta për shkollim është një e drejtë universale. Sistemi arsimor në Kanada drejtohet nga Provinca, jo nga qeveria federale. Si rezultat, kërkesat e shkollave në Alberta janë të ndryshme nga provincat e tjera. Alberta ka një sistem të financuar nga shteti, por ka dy degë të ndryshme të sistemit publik të shkollës, Shkollat Publike (Calgary Board of Education – CBE) dhe Shkollat Katolike (Calgary Separate School District - CSSD). Programet arsimore janë të njëjta, me ndryshimin e vetëm që Shkolla Katolike përfshin mësimin e Biblës.

Të drejtat për arsimim rregullohen nga Ligji mbi Shkollën (School Act) dhe Manuali i Financimit për Drejtorinë Arsimore. Çdo fëmijë duhet të jetë në shkollë nga 6 vjeç deri në 19 vjeç dhe të jetë ose Qytetar Kanadez, Rezident Permanent, apo të ketë prindin Qytetar Kanadez. Financimi për të dy Drejtorinë Arsimore mbështet në taksën mbi pronën e patundshme të qytetarëve.

**Vini re:** Kur zyrtarë të autorizuar nga qeveria trokasin në derën tuaj dhe j'u pyesin, "Cilën Drejtori Arsimore sponsorizoni?" – kjo do të thotë "ku doni të shkojnë taksat tuaja, për Drejtorinë Arsimore Publike apo për atë Katolike?" Vendosni cilën Drejtori Arsimore dëshironi të financoni, Shkollën Publike apo Shkollën Katolike.

**Shqiptari Krenar** - Prindër të nderuar, ju lutemi lexoni për jetën e Fan Nolit me fëmijën tuaj. Në jemi krenar që jemi Shqiptarë, si Fan Noli !

E dini sa shqiptarë me famë ka nëpër botë? Shumë! Janë pikërisht ata njerëzit të cilët përcjellin kudo nëpër botë vlerat e kombit tonë dhe na tregojnë se sa të pasur me famë dhe talente jemi, dhe se mund t'ia dalim kudo. Njeri prej tyre është



**Theofan Noli** i njohur më shumë si **Fan Noli**. Ai ka qenë dramaturg, prift, përkthyes, politikan, diplomat, poet e historian shqiptar. U lind në fshatin shqipfolës İbriktepe, në Turqi. Si disa fshatra të tjerë të asaj krahine të banuar me shqiptarë, Qyteza kishte ruajtur me kohë gjuhën dhe traditat e të parëve. Noli e konsideronte fisin e vet me prejardhje nga Qyteza e Kolonjes në Shqipëri

I ati, Stilian Gjergj Noli, ishte prift i fshatit; e ëma, Marie Gollaqi, ishte shtëpiake. Familja rronte me tokat që kishte si pronë. Në fshatin e lindjes kreu shkollimin fillor në Greqisht për gjashtë vjet, më tej prindët e dërguan në gjimnaz.

Në vitin 1900 nisi punë në një ëmbëltore për ca kohë. Vitin tjetër u nis për në Athinë dhe të njohurit e tij i gjetën vend si nëpunës në një shoqëri belge, e cila kishte konçensionin e tramvajeve me kuaj në qytet. U regjistrua në Fakultetin e Filozofisë në kryeqytetin grek. Më tej, meqë kishte prirje për aktor, punoi si aktor me një trupë teatri me të cilën u end nëpër Greqi për gati dy vjet. Atë periudhë nisi të shkruante skeletin e dramës "Israelitë dhe filistinë". Në fillim të vitit 1903 përktheu në greqisht traktatin e Sami Frasherit "[Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet](#)". Ai u lidh me Rilindjen Kombëtare Shqiptare në Egjipt.

Pas tre vjetësh qëndrimi në Egjipt, në prill 1906 u nis për në Shtetet e Bashkuara, duke kaluar nga Napoli, dhe mbërriti në Nju Jork më 10 maj. Pasi ndenji në Buffalo, ku punoi në një fabrikë të sharrës për tre muaj, Noli shkoi në Boston. Gushtin e 1906 gjeti punë në Filadelfia por e la pasi Sotir Peci i ofroi të bëhej redaktor i revistes Shqip "Kombi".

Ashtu si ne, edhe Fan Noli nuk jetoi në Shqipëri, por ai gjithmone mesoj dhe luftoi për gjuhën tonë të bukur Shqipe.

Keto dite te gjithë femijet ne Shqiperi festuan Diten e Mesuesit me 7 Mars. Ne Mars të vitit 1887 në qytetin e Korces u hap mesonjtorja e pare Shqipe. Kjo ngjarje ishte një fitore e madhe për popullin Shqiptar, pasi deri atëherë dhënia e mësimave ne gjuhen Shqipe bëhej vetem brenda shtëpive në mënyrë të fshehtë, sepse Shqiperia ishte e pushtuar nga turqit. Po te kapeshin duke bere mesim ne Gjuhen Shqipe, mesuesit futeshin ne burg.

Edhe pse në kushte të vështira, kur mësimi i gjuhës shqipe për shkak të kushteve të ndodhura nën sundimin turk ishte reptësisht i ndaluar, mësonjëtorja e Korçës qëndroi e hapur për gati 20 vjet. Kontributi i madh që këta atdhetarë dhe veprimtarë të shquar dhanë për kombin, dëshmohet nga dëshira e zjarrtë që ata kishin për të përhapur Gjuhen Shqipe. Me ato mundësi që kishin ata u bënë iniciatorët e krijimit të teksteve të para shkollore të dokumentuara. Të edukuar me frymën e dashurise per atdhe, nxënësit do të bëheshin në të ardhmen pasuesit e mësuesve të tyre dhe luftëtarë të devotshem per Gjuhen Shqipe.

Edhe ne Kalgari ne uruam mesueset tona per Festen e 7 Marsit.



**Mesuese Flora Dukagjini nga Kosova.**

**Mesuese Liljana Shkurti nga Shqiperia.**

**Mesuese Adriana Bejko nga Shqiperia.**

**Mesueset e shkolles Foleja e Shqiponjave**



**Mesuese Zoica nga Fieri**  
**Mesuese Vjollca nga Shkodra**  
**Mesuese Adriana nga Shkodra**

*Gezuar Diten e Mesuesit, te dashura mesuese!*



## Ne nje festim te hareshem me rastin e 8 Marsit moren pjese shume Nena te Folese. Pse festohet 8 Marsi?

Në përputhje me deklaratën e Partisë Socialiste së Amerikës, dita e parë Nacionale e Gruas, u festua ne SHBA më 28 shkurt 1909. Deri në vitin 1913 kjo ditë vazhdoi të festohej të dielën e fundit të Shkurtit. Në mbledhjen Socialiste Ndërkombëtare në Kopenhagën më 1910, u vendos që 'Dita e Gruas' të festohej në të gjithë botën, për nder të lëvizjes së grave për të drejtat e tyre dhe për ti mbështetur gratë në njohjen e statusit të tyre në shoqëri. Më 8mars të vitit 1910 në SHBA, Kanada e në

vende të tjera të botës u bënë protesta të mëdha për të drejtat e gruas.

Si rrjedhojë e vendimit të marrë në Kopenhagën, një vit më pas, në 1910, Dita e Gruas u vendos të festohej për here të pare në 19 mars, në [Austri](#), [Danimarkë](#), [Gjermani](#) dhe [Zvicër](#), ku miliona burra dhe gra morën pjesë në organizimet kushtuar kësaj dite. **Gratë kërkonin të drejtën e votimit, të qeverisjes, të punës, të edukimit si dhe ndalimin e diskriminimit në punë.** Vetëm pak ditë pas këtij vendimi, në 25 mars, një zjarr tragjik në New York, vrau mbi 140 vajza gjatë orarit të punës. Kjo ngjarje pati një rëndësi të madhe në vendosjen e ligjeve të reja në lidhje me kushtet e punës. Në 1913 gratë ruse festuan Ditën e Gruas, të dielën e fundit të muajit shkurt si pjesë e manifestimeve për paqe. Si rrjedhojë e humbjes së mbi 2 milion ushtarëve rusë gjatë Luftës së Parë Botërore, gratë ruse të dielën e fundit të shkurtit të 1917ës, u bashkuan në greva urie kushtuar "Bukës dhe Paqes". Katër ditë pas fillimit të këtyre grevave, Cari u detyrua të jepte dorëheqjen dhe qeveria e përkohshme ju dha grave nëRusi të drejtën e votës.

Që prej asaj dite "Dita Ndërkombëtare e Gruas" mori dimensione të tjera, dhe filloi të festohej në mbarë Botën. Në këtë dite reflektohet mbi kurajën dhe arritjet e grave të thjeshta të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në historinë boterore. Për çdo 8 Mars fëmijët dhe bashkeshortet në të gjithë botën ju dhurojnë grave dhe nënave të tyre lule ne shenjë respekti dhe dashurie për bashkeshortet dhe nënat e tyre.



*Gezuar festen grave te mrekullueshme Shqiptare!*



## *Te nderuar Prinder,*

Si rezultat i temperaturave te ulta gjate muajit Shkurt dhe Mars, 2019, Bordi i Sholles eshte detyruar te anulloje mesimin ne Folene e Shqiponjave dy here. Ditet e takimeve tona jane shume te kufizuara dhe nuk duam te humbim asnje dite mesimi. Sipas planifikimit fillestar (shihni Librin e Prindit), ne nuk kemi planifikuar ore mesimi per periudhen 17 Mars- 29 Mars pasi kemi ndjekur programin e shkollave publike. Gjate kesaj periudhe femijet jane ne pushimet e pranveres dhe ne nuk duam te behemi pengese per planet qe keni me familjet tuaja. Megjitheate, ne si Bord jemi te gatshem te ofrojme dy dite mesimi gjate kesaj periudhe dhe neqoftese kemi te pakten 5 nxenes per cdo grup ne do te vazhdojme punen normalisht. Ne keto dy takime ne do te desheronim qe femijet nje dite te vizitojne dhe te behen antare te Bibliotekes te mrekullueshme te Kalgarit (downtown) dhe nje dite te organizojme nje vizite ne Kalgari Tower. Megjithese takimet nuk do te jene tek shkolla, mesueset kane gjetur metoda interesante me te cilat femijet do te vazhdojne te punojne me fjalorin e gjuhes shqipe.

**Ju lutemi na ndihmoni me keshillat tuaja per kete propozim duke n'a kontaktuar personalisht ose via e-mail [12dracana@gmail.com](mailto:12dracana@gmail.com).**

## **Familja e madhe e “Folese se Shqiponjave”**

